




BI  **-V**

LABORATOR BIO-DIAGNOSTIK VETERINAR

Adresa: Rruga Haxhi Hysen Dalliu,
Pallati nr. 91, shkalla 1/3 (pranë Prokurorisë së Tiranës)

Tel: +355 42 46 92 07
e-mail: infobiov@gmail.com

Aktinobaciloza në derra

Pleuropneumonia në derra shkaktohet nga *Actinobacillus pleuropneumoniae* (APP) dhe përbën një sëmundje pulmonare shumë ngjitëse e cila shkakton mjaft dëme ekonomike në fermat e derrave. Shenjat klinike në formën acute të sëmundjes janë dispnea, kolla, anoreksia, depresioni, temperature dhe ndonjëherë edhe të vjella. Në mungesë të mjekimit, sëmundja mund të përparojë shumë shpejt dhe brenda pak orëve kafshët mund të ngordhin. Ndërsa infeksionet kronike karakterizohen nga kollë dhe pleurit. Është shumë e rëndësishme të diferencohet infeksioni nga sëmundja, pasi shumë ferma janë të infektuara me APP pa shfaqur shenja klinike apo evidencë të sëmundjes. Derrat bartës të infeksionit e mbajnë shkaktarin e sëmundjes në kavitetin e hundës apo në bajame. Këta përfaqësojnë edhe burimin më të madh të përhapjes së infeksionit në tufa të tjera. Përzjerja e derrave të infektuar me derrat nga tufa të pastra, kushtet e këqia të rritjes, infeksione të tjera në fermë dhe/ose kushtet e stresit bëhen shkak për shfaqje të menjëhershme të rasteve klinike të sëmundjes. Metoda serologjike, nëpërmejt matjes së antitropave në serumin e derrave, bën të mundur zbulimin e serotipeve të ndryshëm të shkaktarit. Gjithashtu bëhet I mundur edhe diferencimi I kafshëve të vaksinuara nga ato të infektuara.

Salmonelozja në derra

Salmonelozja është një nga sëmundjet më të rëndësishme zoonotike. Kjo vjen si pasojë e aftësisë që ka ky mikroorganizëm për tu përshtatur tek pothuajse të gjithë bujtësit. Ushqimet e ndotura me *Salmonela* janë burimi kryesor i infeksionit në njerëz. Programet e kontrollit të salmonelozës bazohen në monitorimin serologjik pasi shërben si mjet i nevojshëm në drejtim të reduktimit të infeksionit, por gjithashtu edhe një mjet për të ndryshuar rutinën e kontaminimit të ushqimeve. Pjesa më e madhe e formave klinike të Salmonelozës në Europë shkaktohet nga *S. typhimurium* që shkakton në derra kryesisht infeksione latente, dhe bashkë me faktorë të tjerë bën të shfaqet sëmundja në derra. Bujtësi primar dhe rezervuari kryesor është derri, dhe ka një rëndësi shumë të madhe për sigurinë ushqimore.

Mycoplasma hyopneumoniae

Pneumonia enzootike ose mykoplazmoza e derrave, është një sëmundje kronike me morbiditet të lartë dhe mortalitet të ulët, e cila shkaktohet nga *Mycoplasma hyopneumoniae*. Shenjat klinike përfshijnë kollën kronike, vonesa në rritje, përhapje të ngadaltë të sëmundjes dhe shpesh përsëritje të klinikës së sëmundjes. Testi i zbulimit të antitropave kundrejt *Mycoplasma hyopneumoniae* lejon një gjurmim të shpejtë çka mund të jetë një indikator i ekspozimit ndaj sëmundjes. Monitorimi I gjendjes imune të tufës ndaj mykoplazmozës, luan një rol shumë të rëndësishëm në kontrollin e sëmundjes.